VENDIM
Nr.475, datë 23.6.2005

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.112, DATË 8.3.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR RUAJTJEN DHE SIGURIMIN E OBJEKTEVE MË TË RËNDËSISHME SHTETËRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "e" të nenit 3 të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 "Për Policinë e Shtetit", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të listës që i bashkëlidhet vendimit nr.112, datë 8.3.2001 të Këshillit të Ministrave, të shtohet emërtesa, si më poshtë vijon:

"15. Godina e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Auditimit.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano